



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br.Prot. Prot No <u>01-1382/2012</u>
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>17-04-2012</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **30.03.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4784/11, për z. Hamdi HOXHA – Menaxher Regjional në Administratën Tatimore të Kosovës, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Lidhur me rastin nr. AKK-03-4784/11 të hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, Hamdi Hoxha – Menaxher Regjional në Administratën Tatimore të Kosovës, janë ndërrmarrë veprimet sipas procedurës së paraparë ligjore, të nevojshme për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).

Rasti është identifikuar me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme.

Një, si Menaxher Regjional në Departamentin e operacioneve, në njëren anë, dhe

dy; ushtrimi i funksionit drejtues në Kompaninë e huaj, “Vegrad” d.d – Përfaqësia Kosovë, në anën tjetër.

Për këtë Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 28.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligji Nr.04/L-051).

Kësaj shkrese Zyrtari i Lartë, i është përgjigjur brenda afatit ligjor dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë, ai është njoftuar për veprimet të cilat, ai në cilësinë e personit të Lartë Zyrtar duhet t'i

ndërmerr, për të shmangur situatën e papajtueshme gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe funksionit drejtues në ndërmarrjen private.

Zyrtari i Lartë, Hamdi Hoxha, me datën 16.03.2012 në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka sjell Informatat mbi biznesin, ("Vegrad" d.d. Përfaqësia Kosovë) të ndryshuara, në të cilat shihet se zyrtari Hamdi Hoxha nuk ushtron më funksion menaxhuese e as drejtues në ndërmarrjen e përmendur. Këto të drejta tani, sipas ligjit, i janë besuar një personi tjetër të zgjedhur nga Kompania e huaj, si pronare e biznesit.

Kështu, me këto informacione zyrtare mbi biznesin, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, që janë sjellë në Agjencinë kundër Korrupsionit nga vet Zyrtari i Lartë dhe kanë numër protokoli DPK/DPKI, 03-1071/2012, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

